



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

Njoftim paraprak përqendrimi

Rasti: Përfitim Kontrolli Raiffesien Leasing SHA / Tirana Leasing SHA

Në datën 23 Korrik 2015, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të përqendrimit në bazë të “Marrëveshjes për shitjen dhe transferimin e portofolit të qerasë financiare” e nënshkruar midis palëve Raiffesien Leasing SHA (Blerësi) dhe Tirana Leasing (Shitësi), më datë 24 Qershor 2015. Përqendrimi ka si objekt përfitim të kontrollit mbi portofolin e qerasë financiare, i cili përbën edhe të gjithë aktivitetin të Tirana Leasing SHA, nga Raiffeisen Leasing SHA.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- **Raiffesien Leasing** : është një institucion financiar jo-bankë e liçencuar nga Banka Shqipërisë për të ushtruar aktivitetin e Qiradhënies Financiare.
- **Tirana Leasing**: është një institucion financiar jo-bankë e liçencuar nga Banka Shqipërisë për të ushtruar aktivitetin e Qiradhënies Financiare. Tirana Leasing është e zotëruar në masën 100% nga Banka e Pireut.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenet 10, pika 1) shkronja b), 12, pika 1) , shkronja a) dhe b) të Ligjit.

Autoriteti i Konkurrencës fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al